

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-129/14

**Prishtinë,
9 qershor 2016**

Në çështjen juridike të

M.N.

Graçanicë/Gračanica

Tel. 049/333-731

Pala ankuese/paraqitesi i kërkesë

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës i përbërë nga Sylejman Nuredini, Kryetar i Kolegjit, Anna Bednarek dhe Beshir Islami, Anëtar, duke vendosur lidhur me ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/212/2013 të datës 21 Gusht 2013 (lënda e regjistruar në AKP me numrin. KPA93099), pas shqyrtimit të mbajtur më 9 qershor 2016, lëshoi këtë:

AKTGJYKIM

Ankesa e M.N. paraqitur kundër vendimit të KPCC/D/A/212/2013 të datës 21 Gusht 2013 sa i përket lëndës së regjistruara në AKP me numrin KPA93099 hidhet si e pasafatshme.

Përmbledhja e çështjeve procedurale dhe faktike:

1. Me 13 Dhjetor 2007, M.N. , ka parashtruar një kërkesë në AKP e regjistruar në nr. KPA10478, në cilësinë e titullarit të bartësit të së drejtës pronësore. Prona e kërkuar gjendet në ngastrat kadastrale nr. 1436 dhe 1437, -zona kadastrale Graçanicë, Komuna e Prishtinës (tani Komuna Graçanicë) me sipërfaqe prej 0 hektarë, 20 ari e 244 metra katrorë.

2. Agjencia Kosovare e Pronave mbi bazën e strukturës së pronës së kërkuar, e ka ndarë kërkesën duke e mbajtur numrin origjinal KPA10478 për ngastrën e tokës 1436 që përfshinë shtëpinë, oborrin dhe kullotën, kurse kërkesa e formuar rishtas me numër KPA93099 përfshinë ngastrën e tokës 1437 me kulturë kullotë, në vendin e quajtur “Selo”, me sipërfaqe prej 0 hektarë 11 ari e 22 metra katrorë(më tej pronë e kërkuar). Ai ka pohuar se është bashkëpronar në pjesë ideale të tokës të cilën e ka fituar me trashëgimi dhe se pronë e kërkuar është e uzurpuar pa të drejtë ligjore nga B.V. .

3. Për ta mbështetur kërkesën e tij M.N. ka paraqitur në AKP dokumentet si në vijim:
 - Letërnjoftimin të lëshuar nga autoritetet e Serbisë dt.3 Shtator 1999
 - Vendim Trashegimor nga Gjykata Komunale e Prishtinës Nr.268/84 dt. 4 Dhjetor 1990 që dëshmon se paraqitësi kërkesës trashëgon 1/5 e pjesës ideale të tërë pasurisë së lënë pas S.N. përfshi edhe pasurinë e kërkuar.
 - Vendim Trashegimie nga Gjykata Komunale e Prishtinës me Nr.38/97 datë 9 Shator 1997 që dëshmon se pala ankuese trashëgon se bashku me të tjerët pasurinë e lënë pas vdekjes së S.N. .
 - Përshkrim i listës poseduese Nr.69 datë 20 Korrik 2004 lëshuar nga Enti I Gjeodezisë së Serbisë- sherbimi për kadaster dhe paluajtëshmeri .
 - Kopje plani date 28 Korrik 2004 lëshuar nga Enti I Gjeodezisë së Serbisë- sherbimi për kadaster dhe paluajtëshmeri .
 - Aktvendim i Gjykatës Komunale në Prishtinë C.Nr.2590/2010 datë 19 Qershor 2013 me të cilin hidhte poshtë si e pasafatshme padia për pengim në ushtruar nga paraqitësi i ankesës.
 - Parashtrësë dorëzuar në AKP-së me daën 25 maj 2008 në të cilën Ankuesi deklaroi se pronë është uzurpuar në vitin 2003 nga B.V. .

4. Më 24 Korrik 2008, një ekip i njoftimi të AKP-së kishte shkuar te prona dhe kishte vendosur një shenjë duke bërë kështu identifikimin e pronës. Në raportin e saj njoftues ekipi i AKP-së kishte shënuar se prona ishte në posedim të N.N. bashkëpronar me parashtruesin e kërkesës. Me 23 Korrik 2013 është bërë identifikimi i pronës dhe ishte kontrolluar dhe krahasuar bazuar në koordinatat e GPS-it dhe ortofoton dhe ishte konstatuar se ai ishte bërë në mënyrë të saktë.
5. Nga raporti i notifikimit të datës 24 Korrik 2008 N.N. në cilësinë e palës përgjegjëse ka nënshkruar njoftimin për pjesmarrje dhe ka deklaruar se është bashkëpronarë i pjesëve ideale. Ai më tej nuk i është përgjigjur njoftimit dhe nuk ka bashkëpunuar me Agjencinë.
6. Në raportin e konsoliduar rë verifikimit të datës 22 Korrik 2013 konstatohet se dokumentet e bashkangjitura kërkesës janë verifikuar pozitivisht.
7. Komisioni për Kërkesa Pronësore i Kosovës (KKPK) në lidhje me pronat e kërkuara, me vendimin e saj KPCC/212/2013 që i referohet lëndës së regjistruar në AKP me numrin KPA93099 i datës 21 Korrik 2013 ka vendosur që kërkesa të hidhet poshtë, me arsyetim se paraqitësi i kërkesave fillimisht kishte deklaruar se e ka humbur posedimin si pasojë e konfliktit të armatosur por në bazë të identifikimit të pronës, informacioneve të marra nga shfrytëzuesi aktual dhe deklaratat e paraqitësit të kërkesës, rrjedh se prona nuk është humbur si pasojë e konfliktit apo rrethanave që ndërlidhen drejtëpërsëdrejti apo rezultojnë nga konflikti.
8. Në paragrafin 18 të vendimit të Komisionit KPCC/212/2013 që i referohet lëndës së regjistruar në AKP me numrin KPA93099 i datës 21 Korrik 2013 komisioni konstaton se bazuar në dokumente të verifikuar nga Sekretariati *ex officio* dhe deklaratës së paraqitësit të kërkesës, del se ka dështuar të dëshmojë se humbja e posedimit është e lidhur me rrethanat që lidhën drejtëpërsë drejti ose rezultojnë nga konflikti i vitit 1998-1999. Rrjedhimisht kërkesa bie jashtë jurisdikcionit të Komisionit dhe si e tillë duhet hidhet poshtë.

Arsyetimi ligjor

Pranueshmëria e ankesave:

9. Parashtruesi i ankesës është njohur me vendimin e Komisionit të datës 18 shkurt 2014, ndërkaq ankesë ka paraqitur më datë 31 Mars 2014. Prandaj, Gjykata gjeti se ankesa është jashtë afatit të përcaktuar me ligj.
10. Pala përgjegjëse në procedurën e shkallës së parë N.N. e ka pranuar vendimin e Komisionit me 5 Shkurt 2014 dhe nuk ka parashtruar ankesë. Me datën 22 tetor 2014 N.N. ka pranuar njoftimin dhe kopjën e Ankesës kundër Vendimit të Komisionit por nuk është përgjigjur në ankesë.
11. Pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe pretendimeve ankimore sipas nenit 194 të Ligjit Nr. 03/L-006 mbi procedurën kontestimore (Gaz. Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.38/2008) (në tekstin e mëtejme LPK), Gjykata lidhur me shqyrtimin e aktgjykimit sipas detyrës zyrtare dhe mbi bazën e shkaqeve e cekura gjeti se:

Ankesa është e pasafatshme.

12. Gjykata Supreme e Kosovës vendosi mbi ankesën si të pasafatshme sipas nenit 186 par. 1 lidhur me nenin 196 të LPK-së. Kjo ngase M.N. në cilësinë e ankuesit vendimin ankimor e ka pranuar më 18 shkurt 2014, ndërkaq ankesë ka paraqitur më datë 31 Mars 2014.
13. Gjykata në shkresat e lëndës gjeti se dorëzimi i vendimit të Komisionit tek parashtruesi i ankesës është bërë në përputhje me nenin 110.1 të LPK-së që parasheh dorëzimin e shkresave personalisht personit të adresuar.
14. Paraqitësi i ankesës nuk ka cekur në ankesë asnjë rrethanë që e ka pamundësuar që ai të ushtroje mjetin ligjor në afat.
15. Nga kjo mund të konstatohet se ankesën e ka paraqitur pas afatit prej 30 ditësh të parashikuar me dispozitën e nenit 12 par. 1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-79. Me këtë dispozitë ligjore parashikohet se ankesa kundër vendimit të KPCC mund të ankimohet brenda afatit prej 30 ditësh nga dita e pranimit.

16. Rrjedhimisht sipas dispozitës së nenit 13 par. 3 nënpar. b) të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-79, duke hedhur ankesën si të pasafatshme, Gjykata nuk ka shqyrtuar meritat e ankesës por është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi

Këshillë ligjore:

Sipas 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet me mjeteve të rregullta apo të jashtëzakonshme juridike.

Sylejman Nuredini, Kryetar i Kolegjit

Anna Benarek, Gjyqtare e EULEX-it

Beshir Islami, Gjyqtar

Sandra Gudaityte, Referent e EULEX-it